

Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 20 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga shoqëria VIVA FRESH SH.P.K. me seli të regjistruar në adresën Magjistralja Prishtina Lipjan NN, Suhodol, Graçanicë, Kosovë, i dorëzuar përmes avokatit **Hekuran Zeqiri** nga Tetova, në seancën e mbajtur më 23.08.2022, solli

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin VIVA FRESH Sh.P.K. me seli në adresën Magjistralja Prishtina Lipjan NN, Suhodol, Graçanicë, Kosovë do të fitojë kontrollin mbi Shoqërinë tregtare KIT-GO SHPKNJP Shtip, me seli në bul. Goce Delçev 52 Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve në shoqëri, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji), më datë 26.11.2021, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftimi i përqendrimit nga VIVA FRESH SH.P.K. me seli në adresën Magjistralja Prishtina Lipjan NN, Suhodol, Graçanicë, Kosovë, me të cilën VIVA FRESH Sh.P.K. do të fitojë kontrollin mbi shoqërinë tregtare KIT-GO SHPKNJP Shtip, me seli në bul. Goce Dellçev 52 Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

VIVA FRESH Sh.P.K. dorëzoi plotësim të njoftimit më datë 02.12.2021.

Me shkresë 08-29, të datës 27.01.2022, Komisioni dorëzoi pranë VIVA FRESH SH.P.K. kërkesë për plotësim të Njoftimit.

VIVA FRESH Sh.P.K. dorëzoi plotësim të njoftimit më 03.02.2022.

VIVA FRESH Sh.P.K. dorëzoi plotësim të njoftimit më 04.02.2022.

Me datë 07.02.2022 me e-mail nga VIVA FRESH Sh.P.K. është kërkuar të dorëzojë plotësim të njoftimit. VIVA FRESH Sh.P.K. dorëzoi plotësim të njoftimit më 11.02.2022.

Me shkresë 08-29, të datës 15.02.2022, Komisioni dorëzoi pranë VIVA FRESH SH.PK. kërkesën për plotësim të Njoftimit, e cila i është dorëzuar me e-mail personit të autorizuar të VIVA FRESH SH.PK - avokatit Hekuran Zeqiri nga Tetova.

VIVA FRESH Sh.P.K. dorëzoi plotësim të njoftimit më 16.02.2022, deri te Komisioni.

Më 18.02.2022, Komisioni dha një vërtetim për marrjen e një njoftimi të rregullt përqendrimi.

Në seancën e mbajtur më 23.03.2022, Komisioni ka miratuar Konkluzion për fillimin e procedurës PA nr. 08-29.

Më datë 29.04.2022, me Konkluzion PA nr. 08-29 nga Shoqëria për tregti dhe shërbime KIPPER SHPK Zhelinë, Komisioni kërkoi dorëzimin e të dhënave të mëposhtme: Totali i të hyrave të realizuara në vitin 2021 të paraqitura individualisht në tregjet që ndodhen në adresën: Bul. "Brigada Maqedonase-Kosovare" nr. 36 Shkup-Çair, Rr. "Xhon Kenedi" nr. 25, Shkup-Çair, "Metodia, Mitevski" nr. 2, Shkup-Çair, Rr. "Bosnja dhe Hercegovina" nr. 10B, Shkup-Butel, rr. "Qemal Sejfula" nr. 2B, Shkup, Çair, rr. "Cvetan Dimov" nr. 150, Shkup-Çair, rr."Petar Maxhunkov" nr. 12a, Shkup- Butel, rr. "Ferid Murati" nr.8, Shkup-Çair, rr. "Indira Gandhi" nr. 55, Shkup-Shuto Orizari, rr. "Radishanska" nr. 18b, Radishani-Butel dhe "Çairska" nr.36, Shkup- Çair.

Më datë 29.04.2022, me Konkluzion PA nr. 08-29 nga Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime GIGO TREJD Dejan SHPKNJP Shkup, Komisioni kërkoi dorëzimin e të dhënave të mëposhtme: Totali i të hyrave të realizuara në vitin 2021 në marketin që gjendet në adresën Rr.Radishanska 6b Shkup-Butel.

Më datë 29.04.2022, me Konkluzion PA nr. 08-29 nga Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime REPTIL SHPKNJP import-eksport Shkup, Komisioni kërkoi dorëzimin e të dhënave të mëposhtme: Totali i të hyrave të realizuara në vitin 2021 të paraqitura individualisht në marketet që ndodhen në adresën: rr. "Radishanska" nr. 4 lokali 1 Shkup, Butel dhe rr. "Aleksandar Urdarevski" nr. 1-1/1 Shkup-Butel.

Më datë 29.04.2022, me Konkluzion PA nr. 08-29 nga Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ZhITO SHPKNJP eksport-import SHPKNJP Veles, Komisioni kërkoi të dorëzohen këto të dhëna: Totali i të hyrave të realizuara në vitin 2021 të paraqitura individualisht në marketet që ndodhen në adresën: rr. "Butelska" pn Shkup-Butel dhe rr. "Butelska" nr. 29B Shkup-Butel.

Më datë 29.04.2022, me Konkluzion PA nr. 08-29 nga Shoqëria tregtare me shumicë dhe pakicë STOKOMAK SHPK import-eksport Shkup, Komisioni kërkoi të dorëzohen këto të dhëna: Totali i të hyrave të realizuara në vitin 2021 të paraqitura individualisht në marketet që ndodhen në adresën: rr.. "Butelska" nr. 38 Shkup-Butel rr. "Blagoja Paroviq" nr.1-1/lokacioni 1 Shkup-Çair rr. "Qemal Sejfula" nr.5/ lokacioni 20 deri 23 Shkup-Çair rr. "Bosnja dhe Hercegovina" nr. 10 Shkup-Butel dhe rruga "Radishanska" nr. 18 B,Radishani, Butel Shkup.

Me datë 29.04.2022 me Konkluzion PA Nr. 08-29 nga Shoqëria tregtare e shërbimeve të transportit të prodhimit ALDIS TREJD SHPKNJP IMPORT-EXPORT Shkup Komisioni kërkoi të dorëzohen këto të dhëna: Të ardhurat totale të realizuara në vitin 2021 veçmas sipas marketeve (duke treguar adresën e marketit).

Më datë 29.04.2022, me Konkluzion PA nr. 08-29 nga Shoqëria Tregtare për prodhimtari, shitje dhe shërbime VEROPULOS SHPKNJP Shkup, Komisioni kërkoi dorëzimin e të dhënave të mëposhtme: Totali

i të hyrave të realizuara në vitin 2021 në marketin që gjendet në adresën rr. "Xhon Kenedi" nr. 2 Shkup-Çair.

Më datë 29.04.2022, me KonkluzionPA nr. 08-29 nga VIVA FRESH SH.P.K, Komisioni kërkoi dorëzimin e të dhënave të mëposhtme: Pasqyra e të ardhurave të VIVA FRESH SH.P.K. nga Kosova për vitin 2021; Pasqyra e të ardhurave të Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime VIVA FRESH STORE SHPKNJP Shkup me seli në "Brigada Maqedonase-Kosovare" 11 nr. 1/1 Shkup-Butel për vitin 2021, Pasqyra e të ardhurave e Shoqërisë për tregti KIT-GO SHPKNJP Shtip me seli në rr. "Goce Dellçev" nr. 52, Shtip për vitin 2021 dhe gjithsej të hyrat e realizuara të Kompanisë Tregtare KIT-GO SHPKNJP në treg në adresën "Aleksandar Urdarevski" nr. 15 Shkup-Butel për vitin 2021.

Me datë 29.04.2022 me Konkluzion pa Nr. 08-29 nga Shoqëria për tregti, prodhim dhe shërbime DIA CENTER SHPK import-eksport Shkup, Komisioni kërkoi të dorëzohen këto të dhëna: Totali i të hyrave të realizuara në vitin 2021 veçmas sipas marketeve (duke treguar adresën e marketit).

Me shkresë të datës 11.05.2022, Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime REPTIL SHPKNJP import-eksport Shkup dorëzoi përgjigje për Konkluzionin nëpërmjet postës elektronike.

Me shkresën të datës 16.05.2022, Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ZhITO SHPKNJP eksport-import SHPKNJP Veles, dorëzoi një përgjigje për Konkluzionin.

Me shkresë të datës 19.05 2022, VIVA FRESH SH.P.K , dorëzoi një përgjigje në lidhje me Konkluzionin.

Me shkresën e datës 20.05.2022, Shoqëria për tregti dhe shërbime RAMSTOR SHPK, ka dorëzuar përgjigje ndaj Konkluzionit.

Me shkresën e datës 20.052022, Shoqëria tregtare për prodhim, shitje dhe shërbime VEROPULOS SHPKNJP Shkup, ka dorëzuar përgjigje në lidhje me Konkluzionin.

Me shkresë të datës 25.05.2022, Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime REPTIL SHPKNJP import-eksport Shkup ,përgjigjen e parashtruar më parë e dorëzoi në origjinal në arkivin e Komisionit.

Më 03.05.2022, personi zyrtar i Komisionit paraqiti deklaratë se Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime GIGO TREJD Dejan SHPKNJP Shkup, refuzoi të pranoj Konkluzionin e PA nr. 08-29 të datës 29.04 2022.

Më 31.05.2022, personi zyrtar i Komisionit paraqiti deklaratë se Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime GIGO TREJD Dejan SHPKNJP Shkup, sërish ka refuzuar të pranojë konkluzionin e PA. nr. 08-29 të datës 29.04.2022, me çka zyrtari ka lënë, 000 Shënim me shkrim në hapësirat e Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime GIGO TREJD Dejan SHPKNJP Shkup.

Më 28.06.2022, me Konkluzion PA nr. 08-29 nga Shoqëria tregtare me pakicë dhe shumicë KAM SHPK Ilinden, Komisioni kërkoi dorëzimin e të dhënave në vijim: Totali i të hyrave të realizuara në vitin 2021 TË paraqitura individualisht në marketet që gjenden në adresën: rr. "Tale Hristov" nr. 2, Shkup-Butel, rr. "Radishanska" nr. 4B, Shkup-Butel, rr. "Qemal Sejfula" nr. 2B Shkup-Çair, rr. "Xhon Kenedi" nr. 18, Shkup-Çair, rr. "Petar Maxhunkov" nr. 16, Shkup-Butel dhe Brigada Maqedonase-Kosovare 1" nr. 67 nd. 2-1/Përdhes, Shkup-Çair.

Me shkresë të datës 29.06.2022, Shoqëria për tregti me shumicë dhe pakicë STOKOMAK SHPK import-eksport Shkup, dorëzoi përgjigje ndaj Konkluzionit.

Me shkresën e datës 30.06 2022, Shoqëria për tregti dhe shërbime KIPPER SHPK Shkup, Zhelinë dorëzoi, përgjigje ndaj Konkluzionit.

Me shkresën e datës 06.07.2022, Shoqëria për tregti me pakicë dhe shumicë KAM SHPK Ilinden ka dorëzuar përgjigje ndaj Konkluzionit.

Më datë 06.07.2022, Komisioni ka miratuar Konkluzionin PA nr. 08-29, i cili autorizoi personat zyrtarë për marrjen e dëshmive në vend nga Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime GIGO TREJD Dejan SHPKNJP Shkup.

Me datë 07.07.2022, personat zyrtarë të Komisionit në vend të ngjarjes kanë kryer marrjen e provave në ndërmarrjen për prodhim, tregti dhe shërbime GIGO TREJD Dejan SHPKNJP Shkup, për të cilin është përpiluar procesverbali nr. 08-29 si dhe është lëshuar vërtetimi për dokumentacionin e marrë.

Më datë 27.07.2022, në hapësirat e Komisionit është mbajtur takimi me përfaqësuesit e parashtruesit të njoftimit – VIVA FRESH SH.P.K. për të cilin është përpiluar një procesverbal. Në takim u ra dakord që afati për marrjen e vendimit të vazhdoj në maksimumin e lejuar ligjërisht.

Më datë 27.07.2022 me shkresën nr. 08-29, Komisioni ka njoftuar parashtruesin e njoftimit - VIVA FRESH SH.P.K. se afati për marrjen e vendimit në procedurën e lëndës zgjatet me 20 ditë pune.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e marrjes së tij dhe në bazë të të dhënave të paraqitura në Njoftimin e Përqendrimit, bashkëngjitjet e tij, shtesat dhe të dhënat e marra shtesë, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve përkatëse:

-Viva Fresh Sh.P.K. nga Kosova është shoqëri që merret me shitje me pakicë të mallrave në shitore-supermarkete jo të specializuara.

Parashtruesi ka një shoqëri të lidhur në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht:

- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime VIVA FRESH STORE SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në brigadën Maqedonase- Kosovare 11 nr. 1/1 Shkup-Butel, me veprimtari prioritare - tregti me pakicë në shitore jo të specializuara, kryesisht me ushqim, pije dhe duhan.

-Shoqëria tregtare KIT-GO DOOEL Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut është shoqëri me objekt të operimit - tregti tjetër me pakicë në shitore jo të specializuara. Gjithashtu ka 58 markete në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shoqëria tregtare KIT-GO SHPKNJP Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut ka shoqëri të lidhura në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht:

-Shoqëria për tregti, hotelieri dhe shërbime TALFA SHPKNJP SHTIP me seli në bul. .Goce Dellçev 52, Shtip-Republika e Maqedonisë së Veriut dhe me veprimtari prioritare - dhënien dhe menaxhimin e pronës së paluajtshme të vetë ose pronë të paluajtshme të marrë me qira (lizing).

-Shoqëria për tregti dhe shërbime TDELTA-ING 2017 SHPKNJP Shtip me seli në bul.Goce Delçev 52, Shtip-Republika e Maqedonisë së Veriut dhe me aktivitet prioritari- dhënien dhe menaxhimin e pronës së paluajtshme të vetë ose pronë të paluajtshme të marrë me qira (lizing).

2. Forma juridike e përqendrimit

Viva Fresh Sh.P.K blen shoqërinë KIT-GO SHPKNJP Shtip në atë mënyrë që pronari shoqërisë KIT-GO Shtip do të ndajë shoqërinë duke e nda me themelimin e një shoqëri të re me ndarjen e të gjitha mjeteve dhe detyrimeve të shoqërisë që nuk kanë lidhje me veprimtarinë e saj kryesore të tregtisë me pakicë të mallrave në dyqane jo të specializuara.

Pas përfundimit të ndarjes së shoqërisë, në shoqëri do të mbeten vetëm mjetet, detyrimet, kontratat dhe punonjësit që kanë të bëjnë me veprimtarinë kryesore të shoqërisë, duke përfshirë edhe shoqëritë e lidhura të KIT-GO Shtip – Shoqëria tregtare, hotelierisë dhe e shërbimeve TALFA SHPKNJ Shtip. , Shtip dhe - Shoqëria për tregti dhe shërbime TDELTA-ING 2017 SHPKNJ Shtip.

Pra, transaksioni në fjalë paraqet përqendrim sepse i përmbush kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

3. Baza juridike e përqendrimit

Baza juridike e përqendrimit është Marrëveshja Paraprake për blerjen e propozuar të KIT-GO SHPKNJ Shtip.

4. Të ardhurat totale vjetore të pjesëmarrësve në përqendrim

Në tregun botëror në vitin 2021 Viva Fresh Sh.P.K. ka realizuar të hyra të përgjithshme në vlerë prej 223.737.171 euro, përkatësisht 13.788.250.637¹ denarë, ndërsa në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka realizuar të hyra totale prej 425.016.695 denarë, gjegjësisht 6.896.598 euro.

Të ardhurat e përgjithshme të KIT-GO Shtip të realizuara nga shitja e mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2021 janë 4.149.157.233 denarë, gjegjësisht 67.326.938 euro.

Të ardhurat totale të përbashkëta vjetore të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqendrimet e arritur me shitjen e mallrave dhe shërbimeve në tregun botëror tejkalon shumë prej 10 milionë euro në kundërvlerë në denarë dhe së paku njëri prej pjesëmarrësve është i regjistruar në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu, të ardhurat e përbashkëta të përgjithshme vjetore të shoqërive pjesëmarrëse në përqendrimin e arritur me shitjen e mallrave dhe shërbimeve në tregun e Republikës së Maqedonisë e tejkalojnë shumë prej 2,5 milionë euro në kundërvlerë në denarë. Rrjedhimisht, për përqendrimin në fjalë ekziston detyrimi që Komisionit t'i dorëzojë njoftim për përqendrim në përputhje me nenin 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

5. Tregjet relevante, përkufizimi dhe pjesët e tregut dhe vlerësimi

Si treg relevant për vlerësimin e përqendrimit në fjalë, Komisioni përcakton tregun me pakicë në dyqane jo të specializuara, markete sepse të dy pjesëmarrësit e tregut janë të pranishëm me shitjen e mallrave me pakicë në dyqane - markete jo të specializuara.

Në lidhje me përkufizimin e tregut gjeografik, Komisioni, me qëllim të vlerësimit të përqendrimit në fjalë, kreu një analizë të pjesës së tregut të dy tregjeve gjeografike të mëposhtme:

- treg me pakicë në dyqane-markete jo të specializuara deri në 500 metra për ata blerës që blerjet i bëjnë në këmbë. Përkatësisht, për blerësit që ecin në këmbë deri te marketet për t'i bërë blerjet e tyre, tregu relevant gjeografik është deri në 500 m, gjegjësisht në rast të ndryshimeve të vogla por të përhershme të çmimeve të produkteve në një market të caktuar, do të riorientoheshin drejt blerjeve në markete të tjera që ndodheshin në një rreze prej 500 metrash dhe nuk do të shkonin më tej pikërisht për faktin se blerjen e bëjnë në këmbë.
- tregu i shitjes me pakicë në dyqane jo të specializuara - markete deri në 3 kilometra për ata blerës që bëjnë blerje me makinë. Gjegjësisht, për blerësit që shkojnë me makinë në markete për të bërë blerjet e tyre, tregu relevant gjeografik është deri në 3 km.

¹ Kursi mesatar i BPRMV 31.12.2021 1 euro = 61.6270 denarë

6. Pjesë të tregut të pjesëmarrësve në tregjet relevante

Siç u tha më lart Viva Fresh Sh.P.K. në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka një market VIVA FRESH STORE SHPKNJP Shkup, me vendndodhje në rr. Brigada Maqedonase-Kosovare 11 nr. 1/1 Shkup-Butel, ndërsa KIT-GO Shtip Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka 58 markete, 5 prej tyre gjenden në Shkup, a prej tyre vetëm një gjendet në Butel, përkatësisht marketi në rr. Aleksandar Urdarevski, nr. 15 Shkup, Butel.

Në tregun e parë relevant: tregu i shitjes me pakicë në dyqane-markete jo të specializuara deri në 500 metra larg, pjesëmarrësit në përqendrim nuk janë të pranishëm në të njëjtin treg. Përkatësisht, marketi VIVA FRESH STORE SHPKNJP Shkup gjendet në rr. Brigada Maqedonase -Kosovare 11 nr.1/1 Shkup dhe në një rreze prej 500m, pjesëmarrësi i dytë nuk është i pranishëm me tregun e vet.

Në tregun e dytë relevant: tregu i shitjes me pakicë në dyqane jo të specializuara - markete deri në 3 km larg, pjesëmarrësit në përqendrim janë të pranishëm në të njëjtin treg. Përkatësisht, marketi VIVA FRESH STORE SHPKNJP Shkup gjendet në rr. Brigada Maqedonase -Kosovare 11 nr. 1/1 Shkup, Butel dhe në një rreze prej 3 km, pjesëmarrësi i dytë KIT-GO Shtip është i pranishëm me marketin e vet që gjendet në rr. Aleksandar Urdarevski 15 Shkup, Butel, gjegjësisht., largësia ndërmjet këtyre dy marketeve është 2,2 km.

Gjatë procedurës, Komisioni ka marrë të dhëna për të hyrat e përgjithshme për vitin 2021 në marketet që ndodhen në një rreze prej 3 km nga tregu i VIVA FRESH STORE SHPKNJP Shkup me vendndodhje në rr. Maqedonase Brigada Maqedonase -Kosovare 11 nr. 1/1 Shkup, Butel dhe në tregun e KIT-GO Shtip me vendndodhje në rr. Aleksandar Urdarevski nr.15 Shkup, Butel dhe i përcaktoi pjesët e mëposhtme të tregut:

- VIVA FRESH STORE SHPKNJP Shkup para përqendrimit kishte një pjesë të tregut prej 11,76%.
- - KIT-GO Shtip (tregu që gjendet në rrugën Aleksandar Urdarevski nr. 15, Shkup, Butel) para përqendrimit kishte një pjesë tregu prej 1.46%
- Pas përqendrimit, pjesa e përbashkët e tregut të pjesëmarrësve të përqendrimit në tregun përkatës të specifikuar do të jetë 13.22%
- Pjesëmarrësit e tjerë në tregun përkatës kishin një pjesë prej 86.78%.

Komisioni e lë të hapur pyetjen nëse për ata konsumatorë që i bëjnë blerjet me makinë, tregu relevant gjeografik mund të jetë më i vogël, duke marrë parasysh faktin se në një rreze prej 3 km nga marketet e pjesëmarrësve në përqendrim, shoqëri të caktuara kanë disa markete që janë më pak se 3 km. larg njëri-tjetrit. Domethënë, nëse tregu relevant gjeografik për ata blerës që bëjnë blerje me makinë do të përkufizohej më pak se 3 km, pjesëmarrja e pjesëmarrësve në përqendrim nuk do të përkojë në të njëjtin treg gjeografik.

Nëse tregu relevant gjeografik për ata blerës që bëjnë blerje me makinë do të përcaktohej si më i madh se 3 km, pjesa e përbashkët e tregut të pjesëmarrësve në përqendrim do të ishte edhe më e vogël, gjegjësisht më pak se 13,22%.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës duke marrë parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi 2 paragrafi 3 dhe paragrafi 4 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe **Udhëzuesi për vlerësimin e përqendrimeve horizontale për qëllime të Ligjit për mbrojtjen e Konkurrencës**, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të

tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски